



Projekti i Binjakezimit AL 13 IB FI 01

*Fuqizimi i kapaciteteve te auditimit te jashtem publik*

# FJALORI I TERMAVE TË AUDITIMIT

Korrik 2018

| TERMI                                    | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | TERM                              | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>AKTIVITETET E KONTROLLIT</b>          | Politikat dhe procedurat që ndihmojnë në sigurimin e zbatimit të direktivave të menaxhimit dhe janë një komponent i → kontrollit të brendshëm. Aktivitetet specifike të kontrollit përfshijnë: -autorizimin, -shqyrtimet, rishikimet e performancës, -përpunimin e informacionit, - kontrollet fizike, - ndarjen e detyrave. | <b>CONTROL ACTIVITIES</b>         | The policies and procedures that help ensure that management directives are carried out, and are a component of →internal control. Specific control activities include:- authorisation; - performance reviews;- information processing;- physical controls;- segregation of duties. |
| <b>ANALIZA E RREZIKUT (VLERËSIMI)</b>    | Një proces i përbërë nga: identifikimi, vlerësimi dhe priorizimi (përparësimi) i ngjarjeve individuale (ngjarjet, rrethanat), të cilat mund të kenë efekt negativ në përmbushjen e një objekti të veçantë.                                                                                                                   | <b>RISK ANALYSIS (ASSESSMENT)</b> | A process consisting of: identification, estimation and prioritisation of individual events (occurrences, circumstances) which may have negative effect on the fulfilment of a particular objective.                                                                                |
| <b>ANOMALI</b>                           | Një deklaram i gabuar ose mosperputhje, i cili në mënyrë të dukshme nuk është përfaqësues i gabimeve apo mospërputhshmërisë në popullatë (në teresinë e të dhenave financiare).                                                                                                                                              | <b>ANOMALY</b>                    | A misstatement or non-compliance which is demonstrably not representative of misstatements or non-compliance in the population.                                                                                                                                                     |
| <b>ARTIKULLI (ELEMENTI) I POPULLSISË</b> | Një pjesë e vetme individuale e një →popullsie, zakonisht një transaksion ose një bilanc, i cili mund t'i nënshtrohet testimit.                                                                                                                                                                                              | <b>POPULATION ITEM</b>            | A single, individual part of a →population, usually a transaction or a balance, which may be subject to testing.                                                                                                                                                                    |
| <b>ATRIBUT-CILESI</b>                    | Një veti, cilesi e artikujve (zerave në kontabilitet) të veçantë → që i përshkruan këto artikuj në mënyrë të plotë nga pikëpamja e                                                                                                                                                                                           | <b>ATTRIBUTE</b>                  | A property of particular →population items describing these items in a complete manner from the point of view                                                                                                                                                                       |

| TERMI                             | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | TERM                     | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|-----------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                   | → objektivit të auditimit.<br>Mund te dallohen dy lloje të atributëve: → atributet sasiore dhe → atributet cilësore.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                          | of the → audit objective.<br>Two types of attributes can be distinguished: → quantitative attributes and → qualitative attributes.                                                                                                                                                                                               |
| ATTRIBUTI (VETIA) SASIOR          | Një → atribut (veti) i një tipi sasiore, vlera e të cilit mund të përcaktohet numerikisht.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | QUANTITATIVE ATTRIBUTE   | An → attribute of a quantitative type the value of which can be determined numerically.                                                                                                                                                                                                                                          |
| ATTRIBUTI KUALITATIV              | Një → atribut vlera e të cilit nuk mund të përcaktohet numerikisht, por vetëm cilësisht (p.sh. rregullsinë / parregullsinë).                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | QUALITATIVE ATTRIBUTE    | An → attribute the value of which cannot be determined numerically but only qualitatively (e.g. regularity/irregularity).                                                                                                                                                                                                        |
| AUDITIM “AD HOC”, I PERKOHSHEM    | Auditimi kryhet sa herë që është e nevojshme (jo i planifikuar).                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | AD HOC AUDIT             | Audit carried out whenever it is necessary (not scheduled).                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| AUDITIM I PËRKOHSHËM (AFAT-MESËM) | Auditim i kryer gjatë veprimeve që i nënshtrohen auditimit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | INTERIM (MID-TERM) AUDIT | Audit carried out during the actions subject to audit.                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| AUDITIMI                          | Një kontroll ose një rishikim që konsiston në përcaktimin e gjendjes aktuale të një institucioni që kontrollon, duke e krahasuar atë me gjendjen e kërkuar/të dëshiruar dhe duke e vlerësuar atë. Auditimet konsiderojnë aspektin e fushës që i nënshtrohet auditimit (→ auditimi financiar, → auditimi i performancës, → auditimi i përputhshmërisë) ose kohën e auditimit (→ auditimi ex ante, → auditimi ex post, → auditimi i ndërmjetëm (afatmesëm)) | AUDIT                    | Check or a review consisting in determining the actual state, comparing it to the required/desired state and evaluating it. Audits consider the aspect of the area subject to audit (→ financial audit, → performance audit, → compliance audit) or audit time (→ ex ante audit, → ex post audit, → interim (mid-term) audit), - |

| TERMI                | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | TERM              | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|----------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| AUDITIMI "EX ANTE"   | Auditim i kryer pas përfundimit të fazës përgatitore të zbatimit të një aktiviteti, programi ose detyre të veçantë, por para se të merret vendimi për zbatimin e këtij aktiviteti.                                                                                                                                                                                                                                                          | EX ANTE AUDIT     | Audit carried out after the completion of the preparatory stage of the implementation of a particular activity, programme or task, but before the decision on the implementation of this activity has been taken.                                                                                                                                                                                   |
| AUDITIMI "EX POST"   | Auditim i kryer pasi që disa veprimeve që i nënshtrohen auditimit janë përfunduar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | EX POST AUDIT     | Audit carried out after certain actions subject to audit have been completed.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| AUDITIMI FINANCIAR   | Auditim i cili fokusohet në përcaktimin nëse informacioni financiar i një njësie ekonomike është paraqitur në përputhje me raportimin financiar dhe kuadrin rregullator të zbatueshëm. Kjo arrihet duke siguruar evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për t'i mundësuar audituesit të shprehë një opinion nëse informacioni financiar është i lirë nga gabimet materiale për shkak të mashtrimit financiar apo gabimit. | FINANCIAL AUDIT   | Audit which focuses on determining whether an entity's financial information is presented in accordance with the applicable financial reporting and regulatory framework. This is accomplished by obtaining sufficient and appropriate audit evidence to enable the auditor to express an opinion as to whether the financial information is free from material misstatement due to fraud or error. |
| AUDITIMI I BRENDSHËM | Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur dhe objektiv, qëllimi i të cilit është të mbështesë kryetarin e njësies në arritjen e qëllimeve dhe detyrave, nëpërmjet vlerësimit sistematik të → kontrollit të brendshëm dhe aktiviteteve këshillimore.                                                                                                                                                                                | INTERNAL AUDITING | Internal auditing is an independent and objective activity, the purpose of which is to support the head of the entity in achieving goals and tasks through systematic assessment of → internal control and advisory activities.                                                                                                                                                                     |

| TERMI                                                         | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | TERM                                             | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|---------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>AUDITIMI I BRENDSHËM</b>                                   | Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur, objektiv i sigurimit dhe konsultimit, i përgatitur për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimet e një organizate. Ai ndihmon një organizatë të përmbushë objektivat e saj, duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e menaxhimit të riskut, kontrollit dhe proceseve të qeverisjes. | <b>INTERNAL AUDITING</b>                         | Internal auditing is an independent, objective assurance and consulting activity designed to add value and improve an organization's operations. It helps an organization accomplish its objectives by bringing a systematic, disciplined approach to evaluate and improve the effectiveness of risk management, control, and governance processes.                                                                            |
| <b>AUDITIMI I INTEGRITETIT</b>                                | Integriteti në auditim përfshin disa aspekte dhe secili prej tyre është po aq i rëndësishëm sa një tjetër. Kur integriteti ekziston në të gjitha fazat e procesit të auditimit, rezultati është një auditim që tregon saktësinë, plotësinë dhe ndershmërinë.                                                                                                                                               | <b>INTEGRITY AUDIT</b>                           | Integrity in auditing involves several aspects and each one is just as important as another. When integrity exists in all phases of the auditing process the result is an audit that exhibits accuracy, completeness and honesty.                                                                                                                                                                                              |
| <b>AUDITIMI I PERFORMANCËS (AUDITIMI I VLERËS PËR PARAVE)</b> | Auditim i cili fokusohet në kryerjen e ndërhyrjeve, programeve dhe veprimtarisë së institucioneve në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, si dhe nëse ka vend për përmirësim. Performanca shqyrtohet kundrejt kritereve të përshtatshme dhe analizohen shkaqet e devijimeve nga ato kritere ose probleme të tjera. Qëllimi është që institucioni që auditohet              | <b>PERFORMANCE AUDIT (VALUE FOR MONEY AUDIT)</b> | Audit which focuses on whether interventions, programmes and institutions are performing in accordance with the principles of economy, efficiency and effectiveness and whether there is room for improvement. Performance is examined against suitable criteria, and the causes of deviations from those criteria or other problems are analysed. The aim is to answer key audit questions and to provide recommendations for |

| TERMI                     | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | TERM                        | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|---------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                           | t'i përgjigjet pyetjeve kryesore të auditimit dhe të japë rekomandime për përmirësim.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                             | improvement.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| AUDITIMI I PËRPUTSHMERISE | Auditim i cili përqendrohet në atë nëse një çështje e veçantë është në përputhje me ligjet dhe rregullat e identifikuara si kritere. Auditimi i përputshmërisë kryhet duke vlerësuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret që drejtojnë subjektin e audituar. Këto kritere mund të përfshijnë ligje, rregulla dhe rregullore, rezoluta buxhetore, politika, kode të themeluara, kushte të miratuara ose parime të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar të sektorit publik dhe sjelljen e zyrtarëve publikë | COMPLIANCE AUDIT            | Audit which focuses on whether a particular subject matter is in compliance with authorities identified as criteria. Compliance auditing is performed by assessing whether activities, financial transactions and information are, in all material respects, in compliance with the authorities which govern the audited entity. These authorities may include rules, laws and regulations, budgetary resolutions, policy, established codes, agreed terms or the general principles governing sound public-sector financial management and the conduct of public officials |
| AUDITIMI I PLANIFIKUAR    | Auditimi i përfshirë në planin e punës së një institucioni auditues.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | PLANNED AUDIT               | Audit included in the work schedule of an auditing entity.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| BESUESHMËRIA E LLOGARIVE  | Në kontekstin e një auditimi financiar, objektivat e auditimit që lidhen me besueshmërinë e llogarive janë: - për llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve (angazhimet dhe ndarjet e pagesave):                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | RELIABILITY OF THE ACCOUNTS | In the context of a financial audit, the audit objectives relevant to the reliability of the accounts are:- for revenue and expenditure accounts (commitment and payment appropriations): completeness, reality of                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |

| TERMI                              | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                           | TERM                      | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                               |
|------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                    | plotësia, realiteti i operacioneve, matja, prezantimi dhe publikimi, - për bilancin : plotësia, ekzistenca dhe pronësia, vlerësimi, prezantimi dhe publikimi.                                                                                                                                        |                           | operations, measurement, presentation and publication;- for the balance sheet: completeness, existence and ownership, valuation and presentation and publication.                                                                         |
| DEKLARATE E GABUAR                 | Një gabim i llogarive që mund të dalin nga mashtrimet financiare apo gabimet njerëzore.                                                                                                                                                                                                              | MISSTATEMENT              | A misstatement of the accounts that can arise from fraud or error.                                                                                                                                                                        |
| DOSJET E AUDITIMIT                 | Të dhënat për planifikimin, kryerjen dhe vlerësimin e rezultateve të auditimit, duke përfshirë ndër të tjera: një → program auditimi, evidenca auditimi → të mbledhura, dokumentimin e analizave vitale(shumë të rëndësishme), opinionet, vërejtjet, konkluzionet dhe rekomandimet nga një auditues. | AUDIT FILES               | Records of planning, carrying out and evaluating audit results, including among others: an →audit programme, gathered →audit evidence, documentation of vital analyses, opinions, remarks, conclusions and recommendations by an auditor. |
| DUKURI                             | Një nga elementët e vlerësimit në → auditimin financiar, që nënkupton kontrollin nëse transaksionet e regjistruara në raportet financiare kanë ndodhur në periudhën përkatëse financiare.                                                                                                            | OCCURRENCE                | One of assessment elements in →financial audit, which denotes checking whether transactions recorded in financial reports have actually occurred in the relevant financial period.                                                        |
| E BESUESHME (EVIDENCA E AUDITIMIT) | Evidenca, provat e auditimit duhet të jenë të paanshme. Kjo paanësi varet nga burimet nga të cilat merren provat dhe nga natyra e asaj evidence (prove).                                                                                                                                             | RELIABLE (AUDIT EVIDENCE) | Audit evidence must be impartial. This impartiality depends upon the sources from which the evidence is obtained and the nature of that evidence.                                                                                         |

| TERMI                                               | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | TERM                                   | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
|-----------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>E MJAFTUESHME<br/>(EVIDENCA E<br/>AUDITIMIT)</b> | Masa e sasisë së provave të auditimit. Dëshmitë e auditimit janë të mjaftueshme nëse, sa i përket sasisë, janë mbledhur mjaft dëshmi të auditimit për të mbështetur përfundimet e nxjerra dhe për këtë arsye opinionin (i auditimit) është shprehur. Sasia e evidencës së nevojshme të auditimit është e ndikuar nga vlerësimi i audituesit për rreziqet e gabimeve materiale dhe gjithashtu nga cilësia (→ rëndësia) e këtyre provave të auditimit. | <b>SUFFICIENT<br/>(AUDIT EVIDENCE)</b> | The measure of the quantity of audit evidence. Audit evidence is sufficient if, in terms of quantity, enough audit evidence has been collected to support the conclusions being drawn and thus the (audit) opinion being expressed. The quantity of the audit evidence needed is affected by the auditor's assessment of the risks of material misstatement and also by the quality (→relevance) of such audit evidence. |
| <b>E RËNDËSISHME<br/>(EVIDENCA E<br/>AUDITIMIT)</b> | Rëndësia e evidencës, provave të auditimit është masa e cilësisë së saj; domethënë, përshtatshmëria dhe besueshmëria e saj në ofrimin e mbështetjes për konkluzionet në të cilat bazohet opinionin i auditimit.                                                                                                                                                                                                                                      | <b>RELEVANT<br/>(AUDIT EVIDENCE)</b>   | Relevance of audit evidence is the measure of its quality; that is, its →appropriateness and its →reliability in providing support for the conclusions on which the audit opinion is based.                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>EFEKTIVITETI</b>                                 | Parimi i efektivitetit ka të bëjë me përmbushjen e objektivave të përcaktuara dhe arritjen e rezultateve të synuara. Një nga kriteret në → auditimin e performancës.                                                                                                                                                                                                                                                                                 | <b>EFFECTIVENESS</b>                   | The principle of effectiveness concerns meeting the objectives set and achieving the intended results. One of the criteria in →performance audit.                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>EFIÇIENCA</b>                                    | Parimi i eficiencës nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet e disponueshme. Ai ka të bëjë me marrëdhënien ndërmjet burimeve të                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | <b>EFFICIENCY</b>                      | The principle of efficiency means getting the most from the available resources. It is concerned with the relationship between resources                                                                                                                                                                                                                                                                                 |

| TERMI                                     | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | TERM        | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|-------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                           | <p>përdorura dhe rezultateve të arritura, në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës. Mund të ketë format e mëposhtme: - prodhimi maksimal (me një cilësi të caktuar) mbi bazën e një inputi (burimi) të dhënë, - input (burim, lëndë e parë) minimal për të marrë një prodhim të caktuar (me cilësi të caktuar). Një nga kriteret në → auditimin e performancës.</p> |             | <p>employed and outputs delivered in terms of quantity, quality and timing. It may have the following forms: - maximum output (of certain quality) available at a given input, - minimum input to obtain a given output (of certain quality). One of the criteria in → performance audit.</p> |
| EKONOMICITETI                             | <p>Parimi i ekonomicitetit nënkupton minimizimin e kostove të burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, me sasinë dhe cilësinë e duhur dhe me çmimin më të mirë. Një nga kriteret në → auditimin e performancës.</p>                                                                                                             | ECONOMY     | <p>The principle of economy means minimising the costs of resources. The resources used should be available in due time, in and of appropriate quantity and quality and at the best price. One of the criteria in → performance audit.</p>                                                    |
| EKSPERT                                   | <p>Një individ që zotëron aftësitë, njohuritë dhe përvojën e dokumentuar (të çertifikuar) në një fushë të caktuar, që nuk është i punësuar as në institucionin auditues apo në njësinë e audituar.</p>                                                                                                                                                              | EXPERT      | <p>An individual holding documented (certified) skills, knowledge and experience in a particular field, not employed either in the auditing entity or in the audited entity.</p>                                                                                                              |
| EKSTRAPOLOJ<br>(SHPERNDAJ OSE<br>ZGJEROJ) | <p>Për të projektuar, rritur ose zgjeruar rezultatet nga një → mostër mbi të gjithë → popullsinë (bashkësinë) e të dhënave, në mënyrë që të jemi në gjendje të nxjerrim konkluzione për atë popullsi.</p>                                                                                                                                                           | EXTRAPOLATE | <p>To project, extend, or expand the results from a → sample onto the whole → population, so as to be able to draw conclusions about that population.</p>                                                                                                                                     |

| TERMI                                         | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | TERM                         | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|-----------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| EKZAMINIM FIZIK                               | Një → procedurë e auditimit e bazuar në vëzhgimin dhe dokumentimin e gjendjes aktuale të elementeve të pronësisë ose procedurave të veçanta.                                                                                                                                                                                                                                                                                     | PHYSICAL EXAMINATION         | An → audit procedure based on observation and documentation of the actual state of property elements or particular proceedings.                                                                                                                                                                                                |
| EKZISTENCA                                    | Një nga elementët e vlerësimit në → auditimin financiar që tregon kontrollin nëse aktivet ose pasivet (detyrimet) e bilancit ekzistojnë aktualisht apo jo, në kohën kur përgatitet bilanci.                                                                                                                                                                                                                                      | EXISTENCE                    | One of assessment elements in → financial audit which denotes checking whether assets or liabilities actually exist at the time when the balance sheet is prepared.                                                                                                                                                            |
| EVIDENCA E AUDITIMIT                          | Të gjitha informacionet e përdorura nga audituesi në arritjen e konkluzioneve ose opinionit. Prova, evidenca e auditimit duhet të jetë → e mjaftueshme për të mbështetur konkluzionet ose opinionin. Përveç kësaj, ajo duhet të jetë → e përshtatshme, përkatësisht → e përshtatshme për objektivat e auditimit dhe → e besueshme. Në mënyrë tipike, evidenca e auditimit është bindëse më shumë se sa konkluduese, përfunduese. | AUDIT EVIDENCE               | All of the information used by the auditor in arriving at the conclusions or opinion. Audit evidence must be → sufficient to support the conclusions or opinion. In addition, it must be → appropriate i.e. → relevant to the audit objectives and → reliable. Typically, audit evidence is persuasive rather than conclusive. |
| EVIDENCA MBËSHTETËSE                          | Dëshmi, evidenca nga një burim i dytë, i cili mbështet evidencat e tjera të marra.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | CORROBORATIVE EVIDENCE       | Evidence from a second source, which supports other evidence obtained.                                                                                                                                                                                                                                                         |
| EVIDENCA (DESHMIA, PROVA) E DUHUR E AUDITIMIT | → Evidenca e auditimit që lejon që objektivat e auditimit të arrihen duke marrë parasysh rreziqet specifike të brendshme dhe/ose të kontrollit.                                                                                                                                                                                                                                                                                  | APPROPRIATE (AUDIT EVIDENCE) | → Audit evidence that allows the objectives of the audit to be achieved whilst taking into account specific inherent and/or control risks.                                                                                                                                                                                     |

| TERMI                                                        | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | TERM                                             | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                 |
|--------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>FAKTORI I JASHTEM (EKZOGJEN)</b>                          | Faktori i pavarur nga një → ndërhyrje që është pjesërisht ose tërësisht shkaku i ndryshimeve (rezultateve dhe impakteve) të vërejtura midis të adresuarve-njësive të audituara (p.sh. kushtet klimatike, evolucioni në situatën ekonomike, performanca e kontraktorëve, sjellja e përfituesve, etj.).       | <b>EXOGENOUS FACTOR</b>                          | Factor independent of a →intervention which is partly or entirely the cause of changes (results and impacts) observed among addressees (e.g. climatic conditions, evolution in economic situation, performance of contractors, beneficiaries' behaviour).   |
| <b>FUSHA E AUDITIMIT</b>                                     | Qëllimi subjektiv dhe objektiv, si dhe kohëzgjatja e një auditimi.                                                                                                                                                                                                                                          | <b>AUDIT SCOPE</b>                               | Subjective and objective scope as well as time span of an audit.                                                                                                                                                                                            |
| <b>GABIM I PRANUESHEM (DEKLARATE E GABUAR E TOLERUESHME)</b> | Një gabim maksimal ose një vlerë e një deklaratë të gabuar në → popullatë që audituesi është në gjendje ta pranojë dhe të japë një opinion pozitiv të auditimit mbi aktivitetin e subjektivit të audituar. Gabimet e pranueshme mund të shprehen në vlera absolute ose relative (→ pragu i materialitetit). | <b>ACCEPTABLE ERROR (TOLERABLE MISSTATEMENT)</b> | A maximum error or misstatement value in →population which the auditor is able to accept and to give a positive audit opinion on the audited entity's activity. Acceptable errors may be expressed in absolute or relative values (→materiality threshold). |
| <b>GABIM I PRITSHËM</b>                                      | Një vlerë gabimi që pritet nga audituesi në një popullatë të caktuar, gjykuar nga njohuritë mbi fushën e audituar dhe nga rezultatet e auditimeve të mëparshme. Përdoret në → metoda statistikore të marrjes së mostrës për të përcaktuar madhësinë e mostrës.                                              | <b>EXPECTED ERROR</b>                            | An error value expected by the auditor in a given population, judged from the knowledge on the audited area and from the results of previous audits. It is used in →statistical sampling methods to determine sample size.                                  |
| <b>GABIM/DEVIJIM I TOLERUESHËM</b>                           | Gabimi maksimal në një popullatë që audituesi                                                                                                                                                                                                                                                               | <b>TOLERABLE ERROR/ DEVIATION</b>                | The maximum error in a population that the auditor                                                                                                                                                                                                          |

| TERMI                  | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | TERM             | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                        | është i gatshëm të pranojë dhe ende të konkludojë se rezultati nga mostra ka arritur objektivin e auditimit.                                                                                                                                                                                                                                 |                  | is willing to accept, and still conclude that the result from the sample has achieved the audit objective.                                                                                                                                                                                                                                                   |
| GABIM-I IZOLUAR        | Një gabim që del nga një ngjarje e izoluar, e cila nuk ka ndodhur veçse në raste të identifikuar në mënyrë specifike. Prandaj dhe ky gabim nuk është përfaqësues i gabimeve në popullatë (tërësinë e zërave në bilanc) dhe në kontekstin e një mostre nuk duhet të projektohet për popullatën.                                               | ERROR - ISOLATED | An error that arises from an isolated event that has not occurred other than on specifically identifiable occasions. It is thus not representative of errors in the population and in the context of a sample should not be projected to the population.                                                                                                     |
| GABIM-I NJOHUR         | Ato gabime që nuk janë identifikuar në bazë të auditimeve të lidhura drejtpërdrejt me një mostër përfaqësuese, por gjatë punës plotësuese të kryer (p.sh. si pjesë e Raporteve Speciale, etj.). Ato nuk janë projektuar për të gjithë popullsinë, por merren në konsideratë në bazë të shumave absolute ose numrit të gabimeve të përfshira. | ERROR - KNOWN    | Those errors which have not been identified on the basis of audits directly linked to a representative sample, but rather during supplementary work carried out (e.g. as part of Special Reports, etc). They are not projected to the entire population, but are taken into consideration on the basis of the absolute amounts or number of errors involved. |
| GJETJET<br>E AUDITIMIT | Një gjendje aktuale e përcaktuar (konstatuar) gjatë një auditimi dhe e mbështetur me → evidencë të auditimit.                                                                                                                                                                                                                                | AUDIT FINDINGS   | An actual state determined during an audit and supported with →audit evidence.                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| GJURMË<br>TË AUDITIMIT | Një përmbledhje (manuale ose automatike) → e evidencave, dëshmime të auditimit, që konfirmon se                                                                                                                                                                                                                                              | AUDIT TRAIL      | A collection of (manual or automated) →audit evidence that confirm that activities laid down in the                                                                                                                                                                                                                                                          |

| TERMI                                                       | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | TERM                                      | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|-------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                             | aktivitetet e përcaktuara në<br>→ kontrollin e brendshëm<br>janë kryer në veprimet e<br>audituar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                                           | →internal control have<br>been carried out on the<br>audited operations.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <b>GYKIMI<br/>PROFESIONAL</b>                               | Përdorimi i njohurive<br>kolektive dhe aftësive dhe<br>përvojës individuale në<br>procesin e auditimit.                                                                                                                                                                                                                                                                                             | <b>PROFESSIONAL<br/>JUDGEMENT</b>         | Using collective knowledge<br>and individual skills and<br>experience to the audit<br>process.                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| <b>HETIM</b>                                                | Kërkimi i informacionit<br>të personave në dijeni,<br>si informacion financiar<br>ashtu dhe jofinanciar,<br>brenda ose jashtë<br>njësisë së audituar (shih<br>→procedurën e auditimit).                                                                                                                                                                                                             | <b>ENQUIRY</b>                            | Seeking information of<br>knowledgeable persons,<br>both financial and<br>nonfinancial, inside or<br>outside the audited entity.<br>(see →audit procedure)                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>I ADRESUARI<br/>(PËRFITUESI) I<br/>DREJTPËRDREJTË</b>    | Personi ose organizata e<br>prekur drejtpërsëdrejti nga<br>→ ndërhyrja. Gjithashtu<br>përdoret shpesh termi<br>“përfitues”. Të adresuarit<br>e drejtpërdrejtë marrin<br>mbështetje, shërbime dhe<br>informacione dhe përdorin<br>mjediset ose mjetet e<br>zhvilluara me mbështetjen<br>e ndërhyrjes.                                                                                                | <b>DIRECT ADDRESSEE<br/>(BENEFICIARY)</b> | Person or organisation<br>directly affected by the<br>→intervention. The term<br>'beneficiary' is also often<br>used. Direct addressees<br>receive support, services<br>and information, and use<br>the facilities developed<br>with the support of the<br>intervention.                                                                                                                |
| <b>I ADRESUARI<br/>(PËRFITUESI) JO I<br/>DREJTPËRDREJTË</b> | Personi ose organizata<br>e cila nuk ka kontakt të<br>drejtpërdrejtë me një →<br>ndërhyrje, por që është<br>ndikuar nga ajo nëpërmjet<br>adresuesve (përfituesve)<br>të drejtpërdrejtë, qoftë<br>pozitivisht (p.sh. një person<br>që merr një punë sepse<br>dikujt tjetër i është dhënë<br>një pension i parakohshëm<br>nën një ndërhyrje) ose<br>negativisht (p.sh. firmat<br>që humbasin biznesin | <b>INDIRECT<br/>ADDRESSEE</b>             | Person or organisation<br>which has no direct contact<br>with an →intervention, but<br>which is affected by it via<br>direct addressees, either<br>positively (e.g. a person<br>obtaining a job because<br>someone else was granted<br>early retirement under an<br>intervention) or negatively<br>(e.g. firms losing business<br>to other firms which have<br>used technology transfer |

| TERMI                                                                         | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | TERM                              | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|-------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                               | nga firmat e tjera të cilat kanë përdorur rrjetet e transferimit të teknologjisë të krijuara nga një ndërhyrje për të përtërirë teknologjinë).                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |                                   | networks set up by an intervention to innovate).                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| INFORMACION FINANCIAR KRAHASUES                                               | Sasi korresponduese dhe nxjerrje të dhënash të tjera të periudhës (periudhave) paraardhëse, të paraqitur për qëllime krahasuese.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | COMPARATIVE FINANCIAL INFORMATION | Corresponding amounts and other disclosures of the preceding financial period(s), presented for comparative purposes.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| INPUTI (BURIMI)                                                               | Burimet financiare, njerëzore dhe materiale që janë mobilizuar për zbatimin e → ndërhyrjes.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | INPUT                             | Financial, human, and material resources that are mobilised for the implementation of a →intervention.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| INSPEKTIM                                                                     | Shqyrtimi i të dhënave ose dokumenteve, qoftë të brendshme apo të jashtme, ose të pasurive të tundshme; (shih → procedurën e auditimit).                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | INSPECTION                        | Examining records or documents, whether internal or external, or tangible assets; (see →audit procedure).                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| KONTABILITET AKRUAL (I BAZUAR NE TE DHENAT KUR ATO NDODHIN, "ACCRUALS-BASED") | Një bazë kontabël sipas së cilës transaksionet dhe ngjarjet e tjera njihen kur ato ndodhin (dhe jo vetëm kur paraja kesh ose ekuivalenti i saj është marrë ose paguar). Prandaj, transaksionet dhe ngjarjet regjistrohen në të dhënat e kontabilitetit dhe njohura në → pasqyrat financiare të periudhave të cilave ato u referojnë. Elementet e njohura nën kontabilitetin akrual janë asetet, detyrimet, mjetet/ kapitali neto, të ardhurat dhe shpenzimet. | ACCRUALS-BASED ACCOUNTING         | A basis of accounting under which transactions and other events are recognised when they occur (and not only when cash or its equivalent is received or paid). Therefore, the transactions and events are recorded in →the accounting records and recognised in the financial statements of the periods to which they relate. The elements recognised under accrual accounting are assets, liabilities, net assets/equity, revenue and expenses. |

| TERMI                                                         | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | TERM                                                  | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                        |
|---------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>KONTABILITET I BAZUAR NE CASH</b>                          | Një metodë e kontabilitetit për regjistrimin e transaksioneve, me të cilën regjistrohen të hyrat vetëm kur janë arkëtuar para dhe shpenzimet regjistrohen vetëm kur të hollat janë disbursuar.                                                                                                              | <b>CASH-BASED ACCOUNTING</b>                          | An accounting method of recording transactions by which revenues are recorded only when cash is received and expenditures are recorded only when cash is disbursed.                                                                                                |
| <b>KONTROLL I PERSHTATSHEM</b>                                | Një →sistem i kontrollit të brendshëm, i planifikuar dhe i organizuar nga drejtuesit në mënyrë të tillë që të sigurojë besueshmëri të arsyeshme të shmangies së rrezikut, si dhe përmbushjen efektive dhe ekonomike të objektivave dhe detyrave të organizatës.                                             | <b>ADEQUATE CONTROL</b>                               | An→ internal control system planned and organised by the management in such a way that it ensures reasonable confidence of risk evasion as well as effective and economical fulfilment of the organisation's objectives and tasks.                                 |
| <b>KONTROLLET</b>                                             | Mekanizma të hartuar për të ruajtur asetet, për të mbajtur afatet, për të siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e raportimit financiar dhe të menaxhimit dhe për të promovuar eficiencën operacionale, efektivitetin dhe përputhshmërinë me të gjitha ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat në fuqi. | <b>CONTROLS</b>                                       | Mechanisms designed to safeguard assets, keep deadlines, ensure accuracy and reliability of financial and management reporting and to promote operational efficiency, effectiveness and compliance with all applicable laws, regulations, policies and procedures. |
| <b>KONTROLLET E APLIKIMIT NË TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT</b> | Procedura manuale ose automatike, qofshin ato parandaluese ose të zbulimit, të cilat janë të dizenuara për të siguruar integritetin e sistemit të TI-së, duke përfshirë të dhënat e kontabilitetit. Ato lidhen me procedurat e përdorura për të nisur, regjistruar,                                         | <b>APPLICATION CONTROLS IN INFORMATION TECHNOLOGY</b> | Manual or automated procedures, whether preventive or detection-oriented, that are designed to ensure the integrity of the IT system including accounting records. They relate to procedures used to initiate, record, process and                                 |

| TERMI                        | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | TERM                    | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                              | procesuar dhe raportuar transaksione ose të dhëna të tjera financiare.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                         | report transactions or other financial data.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>KONTROLLI I BRENDSHËM</b> | Një proces integral (domethënë që përshkruan aktivitetet e një njësie ekonomike) që kryhet nga drejtuesit dhe personeli i një njësie ekonomike dhe është hartuar për të adresuar rreziqet dhe për të dhënë siguri të arsyeshme që, në ndjekje të misionit të organizatës janë duke u realizuar objektivat e përgjithshme të mëposhtme: veprimet e rregullta, etike, ekonomike, eficientese dhe efektive, - përmbushjen e detyrimeve të llogaridhënies, - respektimin e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, dhe - ruajtjen e burimeve nga humbja, keqpërdorimi dhe dëmtimi (shih → komponentët e kontrollit). | <b>INTERNAL CONTROL</b> | An integral process (i.e. that permeate an entity's activities) that is effected by an entity's management and personnel and is designed to address risks and to provide reasonable assurance that, in pursuit of the entity's mission, the following general objectives are being achieved:- executing orderly, ethical, economical, efficient and effective operations;- fulfilling accountability obligations;- complying with applicable laws and regulations; and- safeguarding resources against loss, misuse and damage (see →control components). |
| <b>KONTROLLI I CILËSISË</b>  | Mekanizmat e aplikuar për të siguruar cilësinë e kërkuar të një produkti, programi ose aktiviteti. Duke iu referuar procedurave të kontrollit ose kryerjes së një detyre kontrolli, kontrolli i cilësisë zbatohet me qëllim që të sigurohet që të gjitha veprimet të kryhen në përputhje me → programin e auditimit, praktikën e mirë, manualin e auditimit dhe standardet e miratuara të auditimit.                                                                                                                                                                                                       | <b>QUALITY CONTROL</b>  | Mechanisms applied to ensure the required quality of a product, programme or activity. With reference to control proceedings or performance of an audit task, quality control is applied in order to ensure that all actions are carried out in compliance with →audit programme, good practice, audit manual and adopted auditing standards.                                                                                                                                                                                                             |

| TERMI                                                | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | TERM                                            | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>KORNIZA E MARRJES SË MOSTRAVE</b>                 | Një regjistër ose tregues i artikujve të popullsisë që përdoren për kryerjen e mostrave, si listat e pagave, lista e kontratave të përfunduara, sistemi i identifikimit të taksave etj.                                                                                                                                                          | <b>SAMPLING FRAME</b>                           | A register or denotation of →population items used for carrying out →sampling, such as payroll, list of concluded contracts, tax identification system, etc.                                                                                                                                                         |
| <b>KORNIZA E RAPORTIMIT FINANCIAR TË APLIKUESHËM</b> | Rregullat e kontabilitetit, të zbatueshme për njësinë e audituar, në veçanti duke u bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS) ose në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) / Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).                                                           | <b>APPLICABLE FINANCIAL REPORTING FRAMEWORK</b> | The accounting rules applicable to the audited entity, in particular based on the International Public Sector Accounting Standards (IPSASs) or on the International Accounting Standards (IASs)/International Financial Reporting Standards (IFRSs).                                                                 |
| <b>KORRUPSIONI ADMINISTRATIV</b>                     | Një veprim i qëllimshëm nga ana e një zyrtari publik që ka për qëllim sigurimin e fitimit për njerëz të tjerë, në këmbim të përfitimeve; përdorimi i një zyre publike për përfitime private.                                                                                                                                                     | <b>ADMINISTRATIVE CORRUPTION</b>                | A deliberate action on the part of a public official aimed at providing other people with profit in exchange for illegal benefits; a use of one's public office for private benefits.                                                                                                                                |
| <b>KOSTO-EFEKTIVITET</b>                             | Kosto-efektiviteti i kombinon të dy elementët e eficiencës dhe efektivitetit, duke analizuar marrëdhëniet ndërmjet rezultatit të një ndërhyrjeje dhe kontributit, në aspektin e parave dhe të kapitalit njerëzor. Rezultati i këtij lloji analize mund të tregohet si një raport: kosto për njësi e rezultatit ose prodhimi për njësi të koston. | <b>COST-EFFECTIVENESS</b>                       | Cost-effectiveness combines both elements of efficiency and effectiveness by analysing the relationship between the outcome of an intervention and the input, in terms of money and human capital. The result of this type of analysis can be shown as a ratio: cost per unit of outcome or output per unit of cost. |

| TERMI                          | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                     | TERM                | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                |
|--------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KRITERET                       | Standardet e përdorura për të vlerësuar ose matur çështjen, temën e përzgjedhur për auditim. Kriteret e përshtatshme janë të nevojshme për vlerësimin e arsyeshëm dhe të qëndrueshëm, ose për matjen e çështjes në shqyrtim.                                                   | CRITERIA            | Benchmarks used to evaluate or measure subject matter. Suitable criteria are required for reasonably consistent evaluation or measurement of subject matter.                                                                                               |
| KUFIZIMI NË FUSHËN E AUDITIMIT | Kur audituesi nuk mund të sigurojë dëshmi të mjaftueshme të përshtatshme për të formuar një opinion, qoftë për shkak të kufizimeve të vendosura nga auditimi ose nga rrethanat, ose për shkak të mbajtjes së shënimeve të dobëta.                                              | LIMITATION ON SCOPE | When the auditor cannot obtain sufficient appropriate →evidence to form an opinion, whether due to constraints imposed by the auditee or by circumstances, or due to poor records being maintained.                                                        |
| KUJDESI I DUHUR                | Kujdesi i duhur do të thotë që audituesi duhet të planifikojë dhe të kryejë auditime në një mënyrë të kujdesshme. Audituesit duhet të shmangin çdo sjellje që mund të diskreditojë punën e tyre.                                                                               | DUE CARE            | Due care means that the auditor should plan and conduct audits in a diligent manner. Auditors should avoid any conduct that might discredit their work.                                                                                                    |
| LIGJSHMËRIA                    | Një nga kriteret e auditimit që nënkupton përputhjen me dispozitat kushtetuese dhe rregullatore, me dispozitat e kontratave të ratifikuara ndërkombëtare, me aktet nënligjore dhe aktet ligjore vendore dhe me dispozitat e brendshme që janë në fuqi në periudhën e audituar. | LEGALITY            | One of audit criteria denoting compliance with constitutional and regulatory provisions, with provisions of ratified international contracts, with ordinances and local legal acts, and with internal provisions which are in force in the audited period. |

| TERMI                                 | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | TERM                                | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
|---------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>RISKU I PRANIMIT TË PASAKTË</b>    | Një rrezik (probabiliteti) që një auditues jep një opinion pozitiv mbi një subjekt të testuar, edhe pse ka devijime të rëndësishme nga gjendja e dëshiruar, duke tejkaluar pragun e materialitetit.                                                                                                                                                                                      | <b>RISK OF INCORRECT ACCEPTANCE</b> | A risk (probability) that an auditor issues a positive opinion on a tested subject although there are significant deviations from the desired condition, exceeding the →materiality threshold.                                                                                                                                              |
| <b>RISKU JO NGA MARRJA E MOSTRAVE</b> | Rreziku që del nga faktorët që nuk lidhen me madhësinë e mostrës, që e bëjnë audituesin të arrijë një përfundim të gabuar.                                                                                                                                                                                                                                                               | <b>NON-SAMPLING RISK</b>            | Risk arising from factors, not related to the sample size, that cause the auditor to reach a wrong conclusion.                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>RISKU STATISTIKOR</b>              | Një → risk i marrjes së mostrave në lidhje me mostrën e përzgjedhur me përdorimin e metodave statistikore të marrjes së mostrave.                                                                                                                                                                                                                                                        | <b>STATISTICAL RISK</b>             | A →sampling risk concerning the sample selected with the use of →statistical sampling methods.                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>RISKU (RREZIKU) I KONTROLLIT</b>   | Një rrezik që → kontrolli i brendshëm nuk do të parandalojë ose zbulojë dhe korigjojë në kohën e duhur disa gabime materiale ose parregullsi në menaxhim, të cilat mund të rrjedhin nga mungesa e mekanizmave të përshtatshëm ose nga fakti që mekanizmat ekzistues nuk funksionojnë në mënyrë efektive, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Një nga komponentët e → riskut të auditimit. | <b>CONTROL RISK</b>                 | A risk that →internal control will not prevent or detect and correct in due time some material errors or irregularities in management, which may stem from lack of appropriate mechanisms or from the fact that the existing mechanisms do not operate effectively, continuously and consistently. One of the components of an →audit risk. |
| <b>RREGULLSHMËRIA</b>                 | Koncepti i përdorur në auditimin e përputhshmërisë që aktivitetet, transaksionet                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | <b>REGULARITY</b>                   | The concept used in compliance audit that activities, transactions and information which are                                                                                                                                                                                                                                                |

| TERMI                                 | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                     | TERM                               | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                      |
|---------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                       | dhe informatat të cilat pasqyrohen në pasqyrat e një njësie të audituar duhet të jenë në përputhje me kriteret formale si legjislacioni, rregulloret e nxjerra sipas legjislacionit qeverisës dhe ligjeve, rregulloreve dhe marrëveshjeve të tjera relevante, duke përfshirë ligjet buxhetore. |                                    | reflected in the statements of an audited entity should be in accordance with formal criteria such as legislation, regulations issued under governing legislation and other relevant laws, regulations and agreements, including budgetary laws. |
| <b>RREZIK I RËNDËSISHËM</b>           | Një risk që kërkon konsideratë të veçantë të auditimit.                                                                                                                                                                                                                                        | <b>SIGNIFICANT RISK</b>            | A risk that requires special audit consideration.                                                                                                                                                                                                |
| <b>RREZIKU I REFUZIMIT TË PASAKTË</b> | Një rrezik (probabiliteti) që një auditues jep një opinion negativ mbi një subjekt të testuar, nëse nuk ka devijime të rëndësishme nga gjendja e dëshiruar (devijimet janë që nuk kalojnë prapë në materialitetin).                                                                            | <b>RISK OF INCORRECT REJECTION</b> | A risk (probability) that an auditor issues a negative opinion on a tested subject if there are no significant deviations from the desired condition (deviations which do not exceed the →materiality threshold).                                |
| <b>RREZIKU(RISKU) I ZBULIMIT</b>      | Një rrezik që procedurat substanciale (thelbësore) nuk do të sjellin zbulimin e gabimeve ose parregullsive që mund të jenë materiale. Një nga komponentët e →riskut, rrezikut të auditimit.                                                                                                    | <b>DETECTION RISK</b>              | A risk that substantive procedures will not result in detecting errors or irregularities which may be →material. One of the components of →audit risk.                                                                                           |
| <b>RREZIQET E AUDITIMIT</b>           | Një rrezik që opinionin e auditorit të jetë i pasaktë, pra që audituesi nuk do të raportojë rezerva lidhur me një aktivitet materialisht të parregullt (→ rreziku i pranimit të pasaktë) ose do të shprehë rezerva lidhur me një aktivitet korrekt                                             | <b>AUDIT RISK</b>                  | A risk that the auditor's opinion will be incorrect, i.e. the auditor will not report reservations regarding a materially irregular activity (→risk of incorrect acceptance) or will express reservations regarding                              |

| TERMI                      | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | TERM                        | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|----------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                            | (→ rrezik për refuzim të pasaktë, pra refuzim të një aktiviteti të konsideruar të parregullt, kur është i rregullt). Në auditimin financiar zakonisht ky risk identifikohet vetëm me rrezikun e pranimit të pasaktë. Një rrezik i auditimit përbëhet nga: → risku i përhershëm (i brendshëm), → risku i kontrollit dhe → risku i zbulimit (të parregullsive).                                                                                                                                                                  |                             | a correct activity (→risk of incorrect rejection). In financial audit it is usually identified only with the risk of incorrect acceptance. An audit risk consists of: →inherent risk, →control risk i →detect risk.                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| <b>SIGURI E KUFIZUAR</b>   | Kur jep siguri të kufizuar, përfundimi i auditimit pohon se në bazë të procedurave të kryera, nuk ka asgjë në vëmendjen e audituesit për të bërë që audituesi të besojë se çështja e audituar nuk është në përputhje me kriteret e aplikueshme. Procedurat e kryera në një auditim me siguri të kufizuar janë të kufizuar, a në krahasim me atë që është e nevojshme për të siguruar → siguri të arsyeshme, por niveli i sigurisë pritet, në gjykimin profesional të audituesit, të jetë kuptimplotë për përdoruesit e synuar. | <b>LIMITED ASSURANCE</b>    | When providing limited assurance, the audit conclusion states that, based on the procedures performed, nothing has come to the auditor's attention to cause the auditor to believe that the subject matter is not in compliance with the applicable criteria. The procedures performed in a limited assurance audit are limited compared with what is necessary to obtain →reasonable assurance, but the level of assurance is expected, in the auditor's professional judgement, to be meaningful to the intended users. |
| <b>SIGURIA E ARSYESHME</b> | Një nivel i kënaqshëm besueshmërie, i arritshëm për audituesin në lidhje me rezultatet e auditimit, si dhe formulimin e mendimeve, vërejtjeve dhe konkluzioneve, me kosto të veçantë, përfitime dhe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | <b>REASONABLE ASSURANCE</b> | A satisfactory level of confidence attainable for an auditor with regard to audit results as well as formulated opinions, remarks and conclusions, at particular costs, benefits and at a                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |

| TERMI                                                  | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | TERM                                         | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                       |
|--------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                        | në një nivel të veçantë të rrezikut. Në një → kontroll të brendshëm, termi nënkupton një nivel të kënaqshëm besimi se objektivat e njësive janë arritur, të disponueshme për menaxhimin në bazë të funksionimit të duhur të sistemit.                                                                                  |                                              | particular risk level. In an →internal control, the term means a satisfactory level of confidence that the entity's objectives are achieved, available for the management on the basis of proper functioning of the system.                                       |
| <b>SISTEMI I INFORMACIONIT TE KOMPJUTERIZUAR (CIS)</b> | Një sistem në të cilin një kompjuter është i përfshirë në përpunimin nga entiteti i informacionit që ka rëndësi për auditimin, pavarësisht nga fakti nëse ai kompjuter operohet (menaxhohet) nga njësia ose nga një palë e tretë.                                                                                      | <b>COMPUTERISED INFORMATION SYSTEM (CIS)</b> | A system in which a computer is involved in the processing by the entity of information of significance to the audit, whether that computer is operated by the entity or by a third party.                                                                        |
| <b>SISTEMI I KONTABILITETIT</b>                        | Seria e detyrave dhe të dhënave të një njësie ekonomike, ne të cilën transaksionet dhe ngjarjet janë përpunuar si mjet i mbajtjes së shënimeve financiare. Sisteme të tilla identifikojnë, mbledhin, analizojnë, llogarisin, klasifikojnë, regjistrojnë, përmbledhin dhe raportojnë transaksione dhe ngjarje të tjera. | <b>ACCOUNTING SYSTEM</b>                     | The series of tasks and records of an entity by which transactions and events are processed as means of maintaining financial records. Such systems identify, assemble, analyse, calculate, classify, record, summarise and report transactions and other events. |
| <b>SPEKTICIZMI (DISTANCIMI) PROFESIONAL</b>            | Ruajtja e distancës profesionale dhe një qëndrim në vëmendje dhe në pikëpyetje (testim të përhershëm) gjatë vlerësimit të mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së provave të fituara gjatë                                                                                                                             | <b>PROFESSIONAL SCEPTICISM</b>               | Maintaining of professional distance and an alert and questioning attitude when assessing the sufficiency and appropriateness of evidence obtained throughout the audit. It also entails remaining                                                                |

| TERMI                                                                    | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | TERM                                                     | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|--------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                          | auditimit. Skepticizmi profesional gjithashtu përfshin qëndrimin mendjehapur dhe pranues ndaj të gjitha pikëpamjeve dhe argumenteve.                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                          | open-minded and receptive to all views and arguments.                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| STANDARDIZIMI<br>(PROCES I NIVELIT<br>TE LARTE TE<br>PERFORMANCES)       | Një teknikë e zbatuar në → auditimin e performancës. Bazohet në gjetjen e një standardi të mirë (praktike të mirë) në një aktivitet të caktuar, i cili, sipas mendimit të audituesit, mund të jetë pikë referimi në vlerësimin e një aktiviteti të audituar.                                                                                                                              | BENCHMARKING<br>(HIGH-LEVEL,<br>PERFORMANCE,<br>PROCESS) | A technique applied in →performance audit. It is based on finding a good benchmark (good practice) in a given activity, which in the auditor's opinion may be the point of reference in evaluating an audited activity.                                                                                                                                           |
| SHQYRTIMI, R<br>ISHIKIMI I<br>KONTROLLIT TË<br>CILËSISË<br>SË ANGAZHIMIT | Një proces i hartuar për të siguruar një vlerësim objektiv, gjatë apo para datës së raportit, të vendimeve të rëndësishme të ekipit auditues dhe të konkluzioneve që ai arriti në formulimin e raportit. Personat që kryejnë rishikimin e kontrollit të cilësisë duhet të kenë kualifikime të përshtatshme, përvojë dhe nuk duhet të jenë pjesë e ekipit të angazhimit (ekipit auditues). | ENGAGEMENT<br>QUALITY CONTROL<br>REVIEW                  | A process designed to provide an objective evaluation, on or before the date of the report, of the significant judgments the engagement team made and the conclusions it reached in formulating the report. The persons carrying out the quality control review should have appropriate qualifications, experience and should not be part of the engagement team. |
| SHTRESIM                                                                 | Një → metodë e rastësishme e marrjes së mostrave, e bazuar në ndarjen e një popullsie në një shtresë të veçantë homogjene, që përmban artikuj me atribut të ngjashme → (të tilla si vlera të ngjashme, ekspozim të ngjashëm ndaj                                                                                                                                                          | STRATIFICATION                                           | A →random sampling method based on dividing a →population into separate homogeneous strata, containing items with similar →attributes (such as similar values, exposure to similar risk, etc.), characterised by                                                                                                                                                  |

| TERMI                                    | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | TERM                                       | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                          | <p>rrezikut, etj.), karakterizuar nga ndryshueshmëria e vogël e atributit të dhënë dhe nga marrja e pavarur e mostrave të artikujve nga shtresa të veçanta. Kjo metodë rekomandohet në rastet e ndryshueshmërisë së lartë të atributit (vetisë) të testuar në popullsi; përdorimi i kësaj teknike nxjerr në pah eficiencën e testimit, pra sjell rritjen e saktësisë në një madhësi të caktuar të mostrës.</p> |                                            | <p>little variability of the given attribute, and by independent sampling of items from the particular strata. This method is recommended in cases of high variability of the tested attribute in the population; use of this technique results in increased test efficiency, i.e. in increased →precision at a set sample size.</p> |
| SHTRESIMI(I POPULLSISE)                  | <p>Procesi i ndarjes së popullsisë → në nënpopullata, secila prej të cilave është një grup i njëjësive të marrjes së mostrave, të cilat kanë karakteristika të ngjashme, të tilla si vlera monetare të ngjashme, ekspozimi ndaj rreziqeve të ngjashme etj.</p>                                                                                                                                                 | STRATIFICATION (OF THE POPULATION)         | <p>The process of dividing a →population into sub-populations, each of which is a group of sampling units which have similar characteristics, such as similar monetary values, exposure to similar risks, etc.</p>                                                                                                                   |
| TEKNIKAT E AUDITIMIT KOMPJUTERIK (CAATs) | <p>Aplikimi i → procedurave të auditimit duke përdorur programet kompjuterike që kryejnë teste të auditimit, p.sh. marrjen, klasifikimin, zgjedhjen e të dhënave ose marrjen e provave mbi korrektësinë e përpunimit të të dhënave.</p>                                                                                                                                                                        | COMPUTER-ASSISTED AUDIT TECHNIQUES (CAATs) | <p>The application of →audit procedures using the computer programs carrying out audit tests eg. retrieving, sorting, selecting data or obtaining evidence on the correctness of data processing.</p>                                                                                                                                |
| TEST I VAZHDUESHEM (HAP PAS HAPI)        | <p>Një → procedurë e auditimit që konsiston në ndjekjen e fazave pasuese të një procesi të caktuar, që kryhet në një mostër të operacioneve tipike të përzgjedhura nga audituesi.</p>                                                                                                                                                                                                                          | WALK-THROUGH TEST (STEP BY STEP)           | <p>An →audit procedure consisting in following subsequent stages of a given process taking place on a sample of typical operations selected by the auditor.</p>                                                                                                                                                                      |

| TERMI                             | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | TERM                            | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
|-----------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>TESTET E KONTROLLEVE</b>       | Testet e kryera për të marrë dëshmi auditimi nëse kontrollet kryesore → kanë funksionuar në të vërtetë siç është planifikuar - domethënë vazhdimisht, me qëndrueshmëri dhe në mënyrë eficiente gjatë gjithë periudhës që auditohet - në parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e gabimeve materiale (në rast të → auditimeve financiare) ose rastet e mospërputhjes (në rast të → auditimeve të pajtueshmërisë). | <b>TESTS OF CONTROLS</b>        | Tests performed to obtain audit evidence as to whether key → controls have actually operated as planned - that is to say, continuously, consistently and effectively throughout the period being audited - in preventing, or detecting and correcting, material misstatements (in case of → financial audits) or instances of non-compliance (in case of → compliance audits). |
| <b>TRANSAKSIONI</b>               | 1) Shkëmbim ose transferim të mallrave, shërbimeve ose fondeve.<br>2) Një element i regjistruar në librat e kontabilitetit.                                                                                                                                                                                                                                                                                      | <b>TRANSACTION</b>              | 1) An exchange or transfer of goods, services or funds.<br>2) An item recorded in accounting books.                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>TREGUESIT E PERFORMANCËS</b>   | Rezultatet e matjeve specifike që sigurojnë të dhëna mjaft bindëse, të dobishme, praktike dhe krahasuese (sasiore dhe cilësore) për të përshkruar progresin në arritjen e objektivave, në krahasim me planin.                                                                                                                                                                                                    | <b>PERFORMANCE INDICATORS</b>   | Results of specific measurements providing sufficiently convincing, useful, practical and comparative data (quantitative and qualitative) to describe progress in achieving objectives, as compared to the plan.                                                                                                                                                               |
| <b>VERIFIKIMI</b>                 | Një nga elementët e vlerësimit në → auditimin financiar: kjo nënkupton kontrollin nëse bilanci e regjistruara janë vlerësuar saktë, në përputhje me rregullat e kontabilitetit.                                                                                                                                                                                                                                  | <b>VALUATION</b>                | One of assessment elements in → financial audit: it means checking whether balances recorded have been valued correctly in accordance with accounting rules.                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>VLERA E SHTUAR E AUDITIMIT</b> | Një vlerë e marrë si rezultat i aktiviteteve të përmirësuara që rezultojnë nga një auditim.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | <b>ADDED VALUE OF THE AUDIT</b> | A value obtained as a result of improved activities resulting from an audit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |

| TERMI                                         | PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                         | TERM                               | DESCRIPTION                                                                                                                                                                                                                                         |
|-----------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>VLERESIM ME PERAFERSI I KONTABILITETIT</b> | Një përafrim i sasisë së një artikulli (zëri në llogaritë e kontabilitetit), në mungesë të mjeteve të sakta të matjes.                                                                                                                                                             | <b>ACCOUNTING ESTIMATE</b>         | An approximation of the amount of an item in the absence of precise means of measurement.                                                                                                                                                           |
| <b>VLERËSIMI</b>                              | Objektivi i vlerësimit në auditimin financiar kërkon të sigurojë që aktivi ose pasivi të regjistrohën në shënimet kontabël në një vlerë të përshtatshme (shih objektivin e auditimit).                                                                                             | <b>VALUATION</b>                   | The financial audit objective of valuation seeks to ensure that the asset or liability is entered into the accounting records at an appropriate value. (see audit objective)                                                                        |
| <b>VROJTIM</b>                                | Duke parë një proces ose procedurë që kryhet nga të tjerët (shih → procedurën e auditimit).                                                                                                                                                                                        | <b>OBSERVATION</b>                 | Looking at a process or procedure being performed by others (see →audit procedure).                                                                                                                                                                 |
| <b>ZBULIMI</b>                                | Një nga kriteret e vlerësimit në auditimin financiar, i dizenuar, projektuar për të kontrolluar nëse transaksionet, bilanci, politikat kontabël dhe informacione të tjera të kërkuara paraqiten në përputhje me standardet përkatëse të kontabilitetit dhe me rregullat buxhetore. | <b>DISCLOSURE</b>                  | One of evaluation criteria in financial audit designed to check whether transactions, balances, accounting policies and other required information are properly presented in accordance with the relevant accounting standards and budgetary rules. |
| <b>ZONA/VEPRIME TË NJË RISKU TË LARTË</b>     | Fushat ose veprime që i nënshtrohen auditimit dhe të cilat janë me një → rrezik (risk) të lartë të përhershëm (inherent, të brendshëm) ose me një → risk të lartë të kontrollit.                                                                                                   | <b>HIGH RISK AREAS/ OPERATIONS</b> | Areas or operations subject to audit which are of high →inherent risk or high →control risk.                                                                                                                                                        |